




Media dhe trafikimi i qenieve njerëzore

Udhëzues

Ky projekt financohet nga Bashkimi Europian dhe vihet në jetë nga një konsorcium ndërkombëtar i udhëhequr nga Qendra Ndërkombëtare e Zhvillimit të Politikës së Migrimit (ICMPD) në partneritet me



Ky botim është përpunuar në kuadrin e projektit "Lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe krimit të organizuar - Faza 2", i financuar nga Komisioni Europian dhe i vënë në jetë nga ICMPD në bashkëpunim me Expertise France dhe FIIAPP. Ky botim mori formën e një produkti me ndihmën e Bashkimit Europian.

Autor: Aidan White, Rrjeti i Gazetarisë Etike
(Ethical Journalism Network)



Ekipi i ICMPD: Madis Vainomaa, Ivanka Georgieva,
Edgar Federzoni dos Santos, William Huddleston



E drejta e autorit:

Qendra Ndërkombëtare e Zhvillimit të Politikës së Migrimit (ICMPD), 2017

E drejta e autorit të imazheve qendron me zotëruesit e tyre. Imazhet janë përdorur sipas kushteve të Licencës Creative Commons.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, kopjohet apo transmetohet në çfarëdo lloji forme e mjeti, elektronik apo mekanik, përfshirë fotokopjimin, regjistrimin apo ndonjë sistemi tjetër të depozitimit apo kërkimit të informacionit, pa lejen e zotëruesve të së drejtës së autorit.

Qendra Ndërkombëtare e Zhvillimit të Politikës së Migrimit (ICMPD)

Gonzagagasse 1, 5th floor
Vienna, Austria
A-1010
www.icmpd.org

Përbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e autorëve, Aidan White, Ethical Journalism Network, dhe ICMPD.

Qendra Ndërkombëtare e Zhvillimit të Politikës së Migrimit (ICMPD)

Formatimi nga Marc Rechdane

■ Përmbajtja

01. Hyrje	05
02. Kuptimi i elementeve bazike	07
03. Strategjitë e studios së lajmeve	13
04. Praktika e mirë	15
05. Lidhjet dhe kontaktet	23

01. Hyrje

Përshkrimi i trafikimit njerëzor është një nga detyrat më sfiduese, komplekse dhe sprovuese nga ana etike për gazetarët dhe redaktorët. Është një rrëfenjë që flet për persona që janë jashtëzakonisht të shumtë në numër. Njerëzit që janë viktimë të trafikimit vijnë nga disa kategori qeniesh njerëzore nga më të pambrojturit në planet: janë 40 milionë njerëz që jetojnë në kushte skllavërie; janë 150 milionë fëmijë që janë objekt i punës së të miturve; janë punëtorët migrantë, numri i të cilëve arrin rreth 150 milionë.

Pra, flitet për miliona njerëz - në fakt,

asnjë nuk e di se sa është numri i vërtetë - që janë ngërthyer në rrjetin e trafikimit dhe përshkrimi i rrëfenjës së tyre kërkon së paku kujdes dhe ndjeshmëri, sepse gjuha e përdorur, portretizimi dhe konteksti në të cilin media dhe gazetarët bëjnë raportimin e tyre, mund të jetë i dëmshëm. Mund të ushqejë urrejtjen. Mund të ngurosë e të krijojë stereotipe. Mund të formojë injorancë dhe të ngjallë keqkuptime, duke devijuar vëmendjen nga shkaqet rrënjë dhe duke shkatërruar mundësinë e organizimit të debateve aq të nevojshëm publike mbi si do të mund të zgjidhet kriza.



Fotografia me dashamirësinë e Flickr CC: Esther Vargas (2012)



Këto udhëzime kanë si synim të ndihmojnë redaktorët dhe reporterët të kuptojnë më drejt çështjet dhe t'i formulojnë raportimet e tyre në një mënyrë që të menjanojnë rreziqet që lindin në rast të një përshkrimi agresiv dhe konkurrues nga ana e medias.

Nxitimi për të botuar, madje dhe vetë bota konfuzë dhe shpesh e pabesueshme e medias sociale, fuqizimi i propagandës dhe i ndikimit politik veçse shtojnë shqetësimin që gazetaria po bëhet pre e titujve redaksionalë sensacionalë dhe të copëzave zanore të shkëputura nga regjistrimet që mund të jenë bërë.

Trafikimi i qenieve njerëzore, i cili është i lidhur ngushtësisht me skllavërinë dhe punën e detyruar, është një problem shoqëror kompleks që kërkon një gazetari të vëmendshme, të mirëmen- duar, të informuar, dhe mbi të gjitha, një gazetari të ndjeshme kur jep kon- tekstin e ngjarjes, kur i jep zë viktimave

dhe ndihmon në kërkim të zgjidhjeve.

Media dhe gazetaria duhet të luajnë një rol pozitiv për të bindur botën që trafi- kimi ka mundësi të pakësohet, në mos të çrrënjësohet fare. Udhëheqësit poli- tikë dhe publiku i gjërë kanë nevojë të lexojnë, të dëgjojnë dhe të kuptojnë të gjithë rastin, ngjarjen, në tërësinë e saj. Është një hap i parë thelbësor për gjen- erimin e vullnetit politik për mposhtjen e shkaqeve themelore të trafikimit të qenieve njerëzore.

Këshillat dhe sugjerimet që jepen në këto faqe mund t'i ndihmojnë gaze- tarët që të mendohen dy herë mbi mënyrën e raportimit të rasteve të trafi- kimit; të marrin parasysh çështjet e të drejtave të njeriut që lidhen me rastin në fjalë, me trajtimin e viktimave, me fshehtësinë dhe mirëqenien e tyre; dhe sesi të rrëfëhet historia me humanizëm dhe stil, në ndihmë të audiencave që të kuptojnë më mirë se ç'duhet bërë.

02.

Kuptimi i elementeve bazike

Një gazetari e besueshme kërkon nga reporterët dhe redaktorët që të njohin dhe kuptojnë se për çfarë problemi bëhet fjalë. Fjalët dhe terminologjia që përdorim për të diskutuar trafikimin njerëzor shpesh kanë përkufizime të qarta nga aspekti ligjor. Gazetarët duhet t'i përdorin ato me kujdes dhe me saktësi.


Trafikimi njerëzor i shfrytëzon njerëzit për përfitime, dhe dhunon të drejtat e tyre të njeriut. Trafikantët i shënjestrojnë njerëzit si individë. Zakonisht, ata janë të lidhur me rrjetet kriminale që organizojnë punën e detyruar, punën skllavëruese nëpër familje, shfrytëzimin seksual, skllavërinë, heqjen e organeve. Njerëzit janë të zbuluar ndaj trafikimit në rast se nuk kanë leje të udhëtojnë nga vendi i tyre i origjinës, ose në rast se nuk janë të dokumentuar për të jetuar dhe punuar në vendin e destinacionit.

Lista e kontrollit rreth trafikimit njerëzor:

- Është një krim kundër personit
- Nuk bëhet me dëshirën e personit, ose bëhet pa një dëshirë të vlefshme

ar, të mirë-informuar të personit të përfshirë

- Është pjesë e një marrëdhënieje afat-gjatë dhe me karakter tipik shfrytëzues
- Sjell përfitime nga shfrytëzimi
- Mund të jetë i brendshëm ose ndërkombëtar



Fotografia me dashamirësi e Flickr CC: Rob O'Brien (2012)

Instrumentet kryesore ndërkombëtare dhe ligjore që lidhen me trafikimin njerëzor janë [Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Transnacional](#) (2000) dhe Protokollet në plotësim të saj, veçanërisht Protokolli mbi parandalimin, pengimin dhe dënimin e trafikimit të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve (i njohur, gjithashtu, si Protokolli i Palermos); [Konventa e Këshillit të Europës mbi vëprimin kundër trafikimit të qenieve njerëzore](#) (2005); si dhe [Direktiva e BE 2011/36](#) mbi parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të tij (2011).

Kalimi kontrabandë i migrantëve ka të bëjë me dhënien e ndihmës njerëzve që kërkojnë të bëjnë udhëtime të parregullta duke menjanuar procedurat zyrtare që qeverisin lëvizjen nga një vend në një tjetër. Ky është një krim kundër ligjeve të vendit, dhe jo aq kundër personit. Në shumë raste, kontrabandistët mund të dhunojnë të drejtat njerëzore të migrantëve, por roli i tyre është kryesisht dhe në parim ofrimi i shërbimeve të atilla që kërkohen nga migrantët apo refugjatët, kur këto shërbime nuk ofrohen nëpërmjet një migrimi të rregullt dhe të organizuar.

Sipas [Kombeve të Bashkuara](#) kalimi kontrabandë është: *“prokurimi, me qëllim përftimi, drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt, të një të mire financiare ose materiale, nga hyrja e paligjshme e një personi në një Shtet Palë, i të cilit ky person nuk është një shtetas apo rezident i*

*përhershëm.”*¹

Lista e kontrollit e kontrabandimit të migrantëve:

- Është një krim kundër shtetit
- Bëhet me miratimin e personit në fjalë
- Zakonisht është një marrëdhënie njëherëshetregtare
- Lidhet me pagesën që kërkohet për lehtësimin e migrimit të parregullt
- Kalohet kufiri shtetëror

Mekanizmi Kombëtar i Referimit

është konceptimi i një kuadri brenda të cilit bashkëpunojnë institucionet shtetërore dhe organizatat e shoqërisë civile për të identifikuar viktimat e trafikimit njerëzor apo të skllavërisë dhe që sigurojnë që ata të marrin ndihmën e duhur. Këto mekanizma ekzistojnë në formën e enteve kombëtare ose, disa herë, edhe si praktika bashkëpunimi *de facto* ndërmjet institucioneve shtetërore të mandatuara dhe aktorëve të shoqërisë civile. Këto janë ngritur në përputhje me Konventën e Këshillit të Europës mbi Veprimin kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore. Në themel të mekanizmit të referimit të secilit vend është procesi i lokalizimit dhe identifikimit të viktimave të mundshme.

Mekanizmi Transnacional i Referimit

është një marrëveshje bashkëpunuese për sigurimin e ndihmës gjithëpërf-

¹ Shih https://www.unodc.org/documents/south-eastasiaandpacific/2011/04/som-indonesia/convention_smug_eng.pdf



shirëse **ndërkufitare** dhe/ose të transferimit të personave të identifikuar si persona të trafikuar, ose si viktime të mundshme të trafikimit. Ky mekanizëm mbart në vetvete të gjitha fazat e procesit të referimit që nga intervistimi i parë, dhe më pas atë të identifikimit zyrtar dhe të dhënies së ndihmës, deri te kthimi vullnetar i ndihmuar, përfshirja sociale, dhe procedimet civile e penale.

Ai bazohet mbi bashkëpunimin midis institucioneve qeveritare, agjencie ndër-qeveritare dhe organizatave jo-qeveritare të vendeve të origjinës, të tranzitit dhe të destinacionit për personat e trafikuar të ndihmuar në vendet e ndryshme për të përmbushur detyrimet e veta në drejtim të promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të tyre të njeriut.

Migrantët e parregullt ose pa dokumente, shpesh referohen gabimisht si "ilegalë." Ky është qartësisht një term

paragjykses, por ndonjëherë migrimi mund të jetë ilegal kur njerëzit zgjedhin me dashje të dhunojnë ligjet duke migruar në mënyrë të paligjshme. Përdorimi i termave "i parregullt" dhe "pa dokumente" është i parapëlqyer, por nuk duhet të zbehë paligjshmërinë e kontrabandimit të njerëzve dhe të trafikimit. Jo të gjithë migrantët e parregullt janë të zbuluar ndaj trafikimit, por ata gjithsesi janë në rrezik të shfrytëzimit dhe abuzimit të të drejtave të tyre njerëzore, veçanërisht kur ata përdorin shërbimet e kontrabandistëve. Të qenit me statusin e imigrantit të parregullt në një vend destinacioni, mund të çojë në shfrytëzim të individëve të brishtë, të pambrojtur nga ana e organizatorëve të punës së detyruar dhe skllavërimit.

Skllavëria ose skllavëria moderne është një term i përgjithshëm dhe

përfshirës që ka të bëjë me format e ndryshme të detyrimit dhe shfrytëzimit, të cilat nuk mund t'i refuzojë apo t'u largohet një person, për arsye të kërcënimeve, ushtrimit të dhunës, mashtrimit dhe/ose abuzimit të pushtetit. Skllavëria është e ndaluar specifikisht në legjislacionin ndërkombëtar të së drejtës së njeriut. Ai lidhet edhe me çështje të tjera si martesë e detyruar, puna e detyruar, ose trafikimi i qenieve njerëzore. Për matjen e shtrirjes së skllavërisë, organizatat ndërkombëtare përqendrohen tek numrat e njerëzve që punojnë me detyrim si punëtorë krahë, ose që janë të lidhur në një martesë të detyruar.

Trafikimi për ushtrimin e seksit shfaqet kur një i rritur përfshihet në një akt seksual tregtar, si për shembull prostitucion, që vjen si rezultat i ushtrimit të forcës mbi të, të mashtrimit, kërcënimit ose shtrëngimit;

Trafikimi i fëmijës për ushtrimin e seksit dallon nga trafikimi për seks i një të rrituri në atë që fëmijët nuk mund të konsiderohen asnjëherë sikur kanë pranuar vetë të shiten për të kryer akte seksuale. Termi prostitucioni i fëmijës është një mënyrë e përdorur shpesh, por e pranueshme për të përshkruar shfrytëzimin seksual tregtar të fëmijëve. Prostitucioni i fëmijës është përgjithësisht një formë e krimit të organizuar i drejtuar nga rrjetet kriminale, dhe shpesh përqafohet nga trafikantët e njerëzve.

Martesa e detyruar ndodh kur një grua apo vajzë, apo ndonjëherë një burrë apo djalë, është detyruar të lidhë marrëdhënie martesore kundër vullne-

tit të saj apo të tij. Vajza mund të shitet nga familja e saj, për të shlyer një borxh të familjes, ose për të vënë në vend "nderin" e vajzës;

Robërimi shtëpiak ndodh kur punëtorët në familje nuk lejohen të largohen nga shtëpitë ku punojnë; ata zakonisht paguhen pak, ose aspak, dhe më së shpeshti, abuzohen.

Mbani parasysh: Skllavëria nuk është thjesht një pjesë kurioze dhe e turpshme e historisë njerëzore. Në 2016, sipas Organizatës Ndërkombëtare të Punës, rreth 40.3 milionë burra, gra dhe fëmijë, nga të gjitha vendet e globit ishin viktimë të skllavërisë moderne. Nga këta, rreth 25 milionë ishin pjesë të punës së detyruar, dhe, për më tej, rreth 15 milionë të tjerë jetonin në një martesë të detyruar.² Dhe këto ndeshen sot në lajme.³

Puna e detyruar përkufizohet nga konventa ndërkombëtare e ILO si rasti kur personat shtrëngohen të punojnë nëpërmjet përdorimit të dhunës apo frikësimit, ose nëpërmjet mjeteve më të sofistikuar si borxhi i akumuluar, mbajtja e dokumenteve të identitetit, ose nëpërmjet kërcënimeve të denoncimit tek autoritetet e imigrimit. Pjesa më e madhe e situatave të skllavërimit apo

² Shih http://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/@dgreports/@dcomm/documents/publication/wcms_575540.pdf

³ Shih: <https://www.nytimes.com/2017/11/19/world/africa/libya-migrants-slavery.html>

trafikimit njerëzor lidhet me punën e detyruar.

Puna për larjen e borxhit ndodh kur një person pranon të marrë një borxh, i cili duhet të shlyhet nëpërmjet punës së tyre, por që, në fakt, është një detyrim që vetëm rritet në kohë dhe nuk mund të shlyhet asnjëherë;

Sklavërimi me anë të kontratës

ndodh kur një punëtor mashtrohet dhe hyn në marrëdhënie skllavërie nëpërmjet përdorimit të një kontrate punësimi fallso. Njerëzit gënjehen nga premtimet për punësim, por, sapo mbërrijnë në vendin e punës, detyrohen të punojnë pa u paguar dhe nuk mund të largohen prej andej.

Puna e fëmijës përcaktohet në të drejtën ndërkombëtare. I referohet punës së kryer nga një fëmijë, duke e nënshtruar atë ndaj shfrytëzimit ekonomik, ose që ka të ngjarë të jetë punë e rrezikshme, pengon/ndërpret arsimimin e fëmijës, ose, përndryshe,

është i dëmshëm për zhvillimin e tij/të saj fizik, mendor, shpirtëror, moral apo shoqëror. Mbani parasysh, jo të gjitha punët e kryera nga fëmija është punë e fëmijës, por në rast se ajo vë në rrezik mirëqenien e tij/të saj, i mohon një fëmijëri të shëndetshme apo të drejtën për të shkuar në shkollë, mund të thuhet thujse me siguri se kemi të bëjmë me një abuzim me të drejtat e tij/të saj.

Format më të rënda të punës së fëmijës është një term ndërkombëtar për të përshkruar situatat ku fëmijët detyrohen të punojnë, t'i hyjne rrugës së prostitucionit apo pornografisë, ose të marrin pjesë në veprimtari të paligjshme. Instrumentet kryesore dhe ligjore që lidhen me punën e fëmijës janë [Konventat e Organizatës Ndërkombëtare të Punës](#) dhe [Konventa për të drejtat e fëmijës](#)⁴⁵ e Kombeve të Bashkuara. Përveç këtyre, trafikimi i fëmijëve trajtohet specifikisht nga [Protokolli mbi trafikimin e personave](#) të Kombeve të Bashkuara dhe zbatohet për çdo person nën moshën 18 vjeç.⁶

Synimi global: Eliminimi i punës së fëmijës, i punës së detyruar, i skllavërisë moderne dhe i trafikimit njerëzor janë të gjitha pjesë të një strategjie globale të zhvillimit të miratuar nga Kombet e Bashkuara në 2015. Synimet e Zhvillimit të Qendrueshëm, dhe veçanërisht synimi 8.7, përfshijnë një angazhim për eliminimin e formave më të rënda të punës së fëmijës aty nga 2025. Është një synim tepër optimist.

4 <http://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/CRC.aspx>

5 Shih <http://www.ilo.org/global/standards/subjects-covered-by-international-labour-standards/child-labour/lang-en/index.htm>

6 Shih <http://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/ProtocolTraffickingInPersons.aspx>

03.

Strategjitë e studios së lajmeve

Mbulimi mediatik i trafikimit njerëzor mund të strukturohet në një mënyrë të atillë që të ketë një kontekst, një ndjeshmëri dhe një profesionalizëm në të gjitha aspektet e mbulimit redaksional. Në mënyrë të veçantë, studio e lajmeve duhet të sigurojë që gazetarët të:

Kuptojnë politikën publike mbi trafikimin. Janë një sërë problemesh shoqërore, ekonomike dhe politike që i bëjnë njerëzit të jenë të brishtë ndaj trafikimit dhe shfrytëzimit. Këtu përfshihen rregullat e migrimit, varfëria, diskriminimi racor dhe gjinor, korrupsioni shtetëror dhe ligjet e papërshtatshme që shkojnë bashkë me mosvënien e tyre në jetë, ose jo në mënyrën e duhur. Gazetarët duhet të jenë të vetëdijshëm ndaj këtyre problemeve dhe kushteve.

Shqyrtojnë politikat publike që lidhen me të drejtat e njerëzve sipas standardeve ndërkombëtare, që kanë të bëjnë me mundësinë e përfitimit të procedurave të sigurta dhe të rregullta të udhëtimit, si dhe të lirisë që ata kanë për të kërkuar të drejtat për rezidencë dhe për qasje të tregu i punës në vendet e destinacionit;



Photo courtesy of Flickr CC: Steve Bustin (2014)

Monitorojnë vendet, si ato të destinacionit ashtu dhe të origjinës, nëse kanë të ngritura sisteme për identifikimin e trafikimit dhe për të shqyrtuar nëse kanë në fuqi dispozita për të siguruar mbrojtjen dhe rehabilitimin në nivel kombëtar të fëmijëve dhe të të rriturve të trafikuar;

Vendosin marrëdhënie të mira pune me grupet që punojnë për luftimin e trafikimit, të punës së detyruar, të skllavërisë moderne dhe abuzimit të të drejtave të fëmijëve.⁷ Vihet re shpesh

⁷ Shih Seksionin "Ldhjet dhe kontaktet" e këtyre udhëzimeve

që midis gazetarëve dhe grupeve të interesit, që punojnë në mbrojtje të viktimave/viktimave të mundshme, të mos ekzistojë ai bashkëpunim që kërkohet.

Disa nga këto grupe nuk dëshirojnë të botojnë faktet tronditëse rreth formave të paraportuara të trafikimit apo të punës së detyruar (për shembull, nuk i lejojnë gazetarët që të intervistojnë viktimat). Kur vendosen marrëdhënie dypalëshe më të mira, kjo do të ndihmojë në zgjidhjen e problemit të shkaktuar nga mungesa e një hetimi të besueshëm, e të dhënave në dispozicion të gazetarëve, të materialit që është i domosdoshëm për formulimin e historisë së rastit.

Ndërtimi i besimit: Media dhe OJQ-të mund të punojnë së bashku pa kompromentuar pavarësinë redaksionale, apo pa vënë në rrezik tërësinë e projekteve të ndihmës, apo dinjitetin e personave, viktimat të trafikimit.

Ndërtojnë kapacitet të brendshëm. Të sigurojnë që reporterët të kenë kohën e përshtatshme redaktoriale për të bërë kërkimet dhe të shqyrtojnë informacionin që lidhet me trafikimin dhe

të investojnë tek gazetaria hetimore. Të organizojnë seanca informacioni në studion e lajmeve mbi problemet e trafikimit njerëzor. Të vendosin linja komunikimi falas dhe sisteme të tilla komunikimi me audiencën, duke përfshirë ankimimet mbi çështjet e trafikimit, të migrimit dhe të skllavërisë moderne;

Kontribuojnë në përmirësimin e mbledhjes së të dhënave dhe në shkëmbimin e informacionit mbi trafikimin e personave, punën e detyruar dhe migrimin e parregullt, duke punuar ngushtësisht me autoritetet publike dhe agjencitë ndërkombëtare, në sigurimin e informacionit mbi numrin e viktimave të trafikimit, në mënyrë të veçantë;

Organizojnë fushata me fokus trafikimin dhe çështjet që lidhen me të, për të rritur ndërgjegjësimin publik. Nisma të tilla redaktoriale mund të përforcojnë besimin e publikut tek gazetaria. Disa nga shembujt se në çfarë rastesh angazhimi i medias për këtë problem ka sjellë si rezultat një gazetari me zë të fuqishëm, përfshihen në [Freedom Project from CNN](#) dhe fushatën e Aljazeera [Slavery: A 21st Century Evil](#).



04.

Praktika e mirë

Studiot etike të lajmeve janë thelbësore për një gazetari cilësor. Mbulimi mediatik i trafikimit njerëzor kërkon njohuri dhe respektim të parimeve themelore të raportimit etik. Ato janë:

- 1. Raportimi me korrektësi dhe bazuar në fakte.** Shmangni gënjeshtat dashakeqëse, lajmet fallso dhe informacionin e paverifikuar.
- 2. Pavarësia.** Veproni sipas ndërgjegjes suaj. Mos u ngatërroni me propagandën anti-migrim, apo mos u bëni zëri mbrojtës i interesave politike apo i interesave të natyrave të tjera.
- 3. Paanshmëria.** Mbani parasysh që të tregoni të gjitha anët e historisë së rastit. Në mënyrë të veçantë, jepuni zë viktimave dhe të mbijetuarve të traumës së trafikimit, duke pasqyruar, në të njëjtën kohë, shqetësimet e ligjshme të njerëzve që jetojnë në vendet pritëse.
- 4. Humanizmi.** Gazetaria nuk duhet të shkaktojë dëm. Tregoni ndjeshmëri

kur raportoni. Synoni zgjidhjet e problemeve fizike dhe emocionale, dhe të krizës që po përjetojnë e kalojnë personat e trafikuar.

5. Llogaridhënia dhe transparenca.

Jini të përgjegjshëm për punën që kryeni. Korrigjoni gabimet dhe zbuloni se kush jeni dhe të jeni të hapur për metodat e punës suaj.

Gazetarët duhet t'i venë në jetë këto vlera bazike në të gjitha aspektet e punës së tyre. Mbani parasysh që gazetarët kanë një detyrë specifike për të treguar dhe ushqyer respekt ndaj njerëzve që janë viktimë të traumave, të atilla siç shkakton trafikimi. Kodi i Etikës i Shoqatës së Fotografëve të Shtypit Kombëtar (The National Press Photographers Association) në Shtetet e Bashkuara, deklaron, për shembull:

"Trajto të gjitha subjektet me respekt dhe dinjitet. Përkushto vëmendje të veçantë subjekteve të brishta dhe ndjeshmëri ndaj viktimave të krimit ose të tragjedisë. Ndërhy në momentet private të brengës së tyre vetëm kur ekziston një nevojë e

justifikueshme dhe mbizotëruese në publik për të kuptuar më mirë.”⁸

Pyetjet E Fillimit

Këto pyetje do t'i ndihmojnë gazetarët të identifikojnë rastet e trafikimit. Në rast se përgjigja është “po” për ndonjë nga pyetjet e mëposhtme, atëhere vepro me kujdes dhe përdor burimet e dhëna në këto udhëzime për të kërkuar këshilla.

1. Personi me të cilin po merremi, mos është detyruar me forcë në këtë gjendje nëpërmjet përdorimit të dhunës, ngacmimeve psikologjike apo formave të tjera të kontrollimit të tij/të saj?
2. A janë viktima të dhunës dhe kërcënimit?
3. A u detyrua që të paguajë të holla?
4. A janë bërë objekt i shtrëngimit nga ndonjë person në pozicionin e të fortit dhe që ka pushtet mbi ta?

Në terma të përgjithshëm, gazetarët dhe redaktorët duhet të menjanojnë kurthet e keqinformimit, të lajmeve fallso që mund të vijnë nga rrjetet sociale dhe propaganda e shpërndarë për interes të veçanta. Ata mund ta bëjnë këtë, në rast se:

Bazohen mbi fakte, janë skeptikë rreth statistikave. Numrat ndihmo-

jnë historitë, por mund të jenë të gënjeshtërt. Për shkak të natyrës së fshehtë dhe sekrete të dukurisë së trafikimit, sklavërisë moderne dhe punës së detyruar, nuk është e mundur që të përftohen numrat e saktë të personave. Ekziston një rrezik i përhershëm i të dhënave të fabrikuara. Gazetarët duhet të verifikojnë dhe hetojnë pretendimet mbi numra; ata duhet të verifikojnë me fakte statistikat që ofrohen, dhe, po të jetë e nevojshme, t'i japin publikut paralajmërime rreth informacioneve të paverifikuara.

Mbani parasysh që, vlerësimet më të besueshme vijnë nga Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO) dhe entet e tjera ndërkombëtare që përmenden në këto udhëzime, por edhe këto vlerësime dhe mënyra se si është arritur deri tek ato, duhet të jenë objekt i analizës së gazetarit.

Kundërshtojnë konceptimet e gabuara. Një keqkuptim i përhapur i shkaktuar nga fokusimi i medias mbi seksin dhe sensacionalizmin është që trafikimi njerëzor ka të bëjë kryesisht me shfrytëzimin seksual dhe se u ndodh, para së gjithash, grave dhe vajzave. Në fakt, trafikimi ndodh më shumë në tregun e punës së detyruar, sesa në shfrytëzimin seksual. Trafikimi për shfrytëzim seksual (edhe të burrave e djemve) është një shqetësim i rëndësishëm që duhet luftuar, por kjo nuk duhet të ndodhë në kurriz të lënies menjëherë të trafikimit për punë të detyruar.

Janë pozitivë dhe tregojnë zgjidhjet. Është e rëndësishme që të fokusohet mbi mundësinë e rikuperimit dhe

⁸ Në faqen <http://accountablejournalism.org> ekziston një listë e plotë e kodeve dhe e standardeve për gazetarët

risjelljes në jetë normale të njerëzve që janë viktimë. Personat që rikupero-
hen dhe mbijetojnë, kanë mundësi të
rrëfejnë historitë e tyre. Paraqitja e një
këndvështrimi pozitiv dhe të balanc-
uar ndihmon në ndërtimin e besimit të
audiences në atë që thua. Gjatë punës
suaj hetimore shqyrtoni politikat që
zbatohen dhe bëj pyetjen se si mund të
përmirësohen ato.

Ndjekin paranë. Industria e trafikimit
dhe e skllavërimit modern krijon punën
e detyruar që të çon në mallra më të
lira për të gjithë. Është një industri
globale dhe kërkon të bëhen hetime
mbi mënyrën si vepron, si brenda ven-
dit ashtu dhe jashtë tij.

Janë sjellë disa shembuj të shkëlqyer të
punës hetimore – si për shembull doku-
mentari i BBC *Humans for Sale*, ose një
program i ngjashëm nga *ARD in Germa-
ny*, të transmetuara të dyja këto në 2017.

Media mund të shqyrtojë, gjithash-
tu, se si shërbimet lokale për punë të
tilla të pakualifikuara (si larje makinash,
shërbime manikuristësh, punë krah-
u në kantiere ndërtimi) i kanë ndërtuar
modelet e biznesit të tyre mbi punën
me kosto të lirë. Personat që punojnë
në mjedise të tilla a mund të jenë per-
sona të trafikuar, të shfrytëzuar? Gaze-
tarët mund të ndjekin paranë dhe të
kërkojnë lëndën e parë që ka prodhuar
këto para, që mund të jetë një punë skl-
lavëruese. Ata mund t'i tregojnë audi-
encës se si ne të gjithë mund të kemi
të bëjmë, në një mënyrë apo tjetër, me
trafikimin njerëzor. Kjo tërheq vemend-
jen e njerëzve.

Japin shpresë. Është e lehtë për publi-
kun që të mendojë për njerëzit viktimë
të trafikimit apo të punës së detyruar si
individë të pafuqishëm e të dëmtuar
për jetë. Por kjo nuk është gjithmonë
e vërtetë. Një gazetari që ndriçon as-
pekte të tilla si rikuperimi njerëzor dhe
përshtetshëm raste kur njerëzit arrijnë të
rindërtojnë jetën e tyre duke lënë prapa
tragjedinë e skllavërisë moderne dhe
të punës së detyruar, është një gazetari
që tregon një histori të ndryshme nga
ato të zakonshme.

Udhëzime Rreth Intervistimit

Tragjedia e trafikimit dhe e skllavërisë
është me vlerë të tregohet, por, duke
qenë se është një krim i fshehtë, kër-
kohet përdorimi i një numri të madh
burimesh për të mbështetur gazetarinë
hetimore. Qasja tek të mbijetuarit është,
ndonjëherë, e vështirë, dhe është zëri i
tyre ai që luan një rol madhor në orien-
timin e rastit në rrjedhën e duhur.

Mbani parasysh: media e lajmeve
ka fuqi të madhe. Njerëzve mund t'u
vijë mirë kur atyre u afrohen report-
erët, pa kuptuar plotësisht rreziqet
me të cilat mund të ndeshen, ata dhe
të tjerët, kur dalin para publikut. Kjo
është e vërtetë në mënyrë të veçantë
për personat që janë bërë pre e
dramave dhe tragjedi të trafikimit
njerëzor, po aq sa edhe ata që janë
të përfshirë në fatqekësi humanitare,
lufta apo ngjarje të tjera traumatike.

Gazetarët duhet të jenë sa më shumë transparentë që të jetë e mundur në marrëdhëniet me burimet e tyre dhe veçanërisht me viktimat dhe të mbijetuarit e trafikimit njerëzor. Gazetarët duhet të:

- Identifikojnë nëse kanë të bëjnë me një të mitur. Nën 18 vjeç, ose nën moshën kur mund t'u merret parasysh dhënia e pëlqimit nga ana e tyre.
- Vlerësojnë brishtësinë e burimeve (veçanërisht të të rinjve, ose personave që kanë qenë viktimat të traumës dhe dhunës);
- Respektojnë fshehtësinë. Çdo njeri ka të drejtën e fshehtësisë dhe të trajtimit me respekt, veçanërisht fëmijët;
- Sigurojnë që fëmijët të intervistohen në prani të një të rrituri përgjegjës të tij, ose të një kujdestari;
- Shpjegojnë procesin e raportimit dhe përse tregimi i tyre është i rëndësishëm;
- Menjanojnë, përveç në rrethana të jashtëzakonshme, përdorimin e hiles apo të mashtrimit kur raportojnë rastet e trafikimit.

Mbani parasysh: në rast se viktimat nuk ka prindër apo kujdestar, ose është analfabet dhe nuk di të lexojë, dhe në rast se organizata që përgjigjet për të mbijetuarin nuk respekton etikën dhe është e pabesueshme, gazetari duhet të mbështetet në ndërgjegjen dhe gjykimin e tij etik. Ky është momenti, mbi gjithë të tjerët, kur duhet të shfaqet etika dhe humanizmi.

Më poshtë është një listë kontrolli shtesë e pyetjeve që do të përdorë një gazetar etik gjatë intervistimit të dikujt që është një i/e mbijetuar e trafikimit njerëzor:

- A ua kam bërë të qartë se përse po e bëj këtë intervistë dhe se cili është qëllimi i raportimit tim? A jam treguar tërësisht transparent mbi synimet e mia?
- A i kam marrë masat për t'i mbrojtur ata – për shembull, nëse një i ri/e re, ose dikush në rrethana të pambrojtura – për të siguruar që ata ta kenë të qartë se cilat mund të jenë pasojat e mundshme të botimit të informacionit që japin?
- A jam unë i/e sigurt që ata i kanë kuptuar plotësisht kushtet e intervistës sime, dhe se çfarë nënkuptoj unë me informacionin që nuk do të bëhet publik, me përshkrimin e mjedisit dhe me mos citimin e burimit, apo rrethanat e tjera?
- Nëse një burim pyet rreth kushteve para se të pajtohet me dhënien e intervistës, cilat do të ishin kufizimet e mia? A duhet të paguaj për shpenzimet e një burimi dhe që lidhen me kushtet e intervistimit? Cilat do të ishin kostot legjitime që mund të mbulohen?
- A do bie dakord që të mbështesë më tej burimet, si për shembull, për përfaqësimin ligjor, në rast se lindin probleme për shkak të raportimit tim?
- A kam marrë leje para se të bëj fo-

tografi apo para regjistrimit me zë dhe me video?

- A kam bërë pyetjet e duhura, a kam menjanuar ripërjetimin e përvojave traumatike, dhe a kam lejuar që i/e intervistuari të flasë lirisht?
- A u fokusova mbi apsektet pozitive të përjetimeve të të intervistuarit, dhe a e sqarova që i/e intervistuari mund të kontrollojë raportin tim për ndonjë gabim faktik para botimit të tij?
- A u parashtruan të gjitha pyetjet e rëndësishme? Dhe a isha i ku-

jedesshëm dhe i ndjeshëm në mbrojtje të interesave të të intervistuarit?

Anonimati është një e drejtë që duhet të gëzohet nga ata që kanë nevojë për të, por asnjëherë nuk u jepet lirisht të gjithëve. Kur flitet për trafikimin njerëzor, mbrojtja e personave më të brishtë kërkon nga gazetarët që ta ofrojnë atë, pavarësisht nëse viktimat e kërkojnë ose jo; anonimati duhet të konsiderohet për viktimat e abuzimit dhe për ata që mund të vihen në rrezik nëse zbulohet identiteti i tyre.

A duhet që gazetarët të thyejnë rregullat në emër të humanizmit?

Ndonjëherë gazetarët mund të krijojnë marrëdhënie me burimet e tyre, që mund të jenë të dyshimta dhe mund të minojnë bazën etike të punës së tyre. Në 2014 gazetari suedez i lajmeve Fredrik Önnvall u miqësua me një refugjat sirian 15 vjeçar, kur ishte me mision për të mbuluar çështjet e krizës së migrimit në Siri. Ai dhe ekipi i tij vendosën që ta marrin djalin në Suedi. Dokumentari që ata prodhuan mbi udhëtimin e djalit u transmetua në televizionin publik suedez dhe u mirëprit me entuziazëm, por, më vonë gazetari u ndoq penalisht dhe u dënua për kalim kontrabandë të personit. Veprimi i tij ngjalli një debat të ashpër brenda rrethëve të gazetarisë mbi rolin që duhet të luajnë gazetarët kur raportojnë - a duhet të bëhen pjesëmarrës të rastit, apo të mbeten thjesht vëzhgues?



photo courtesy of Flickr CC: Yan Arief (2007)

Udhëzime Për Foto-Gazetarinë

Çdo gazetar kërkon të bëjë intervista, fotografi dhe video të personave që ndodhen nën çfarëdo forme të skllavërimit apo të punës së detyruar. Drama dhe tragjedia e vdekjeve të migrantëve, që shpesh kanë të bëjnë me njerëz të kapur në rrjetin e trafikimit, përbën një burim të pasur pamjesh të fuqishme, por shumë nga ato janë të diskutueshme.

Mbani parasysh që dërgimi i një ekipi lajmesh në një situatë ku ka njerëz të pambrojtur, të tmerruar dhe të shfrytëzuar, mund të jetë traumatike. Gazetarët duhet të bëjnë gjithçka që mundën për të krijuar një mjedis e atmosferë të sigurt dhe qetësues kur filmojnë personat që kanë qene viktime të trafikimit.

Gazetaria forcohet nga përdorimi i pamjeve të forta kur përshkruajnë rastin, por është jetësore që media të jetë e kujdesshme dhe të menjanojë krimin e përshtypjeve sipërfaqësore, që nuk bëjnë gjë tjetër, veçse përforcojnë stereotipat.

Menjanoni përdorimin e fotove apo krijimin e videove që synojnë sensacionin, ndërhyrjen dhe kënaqësitë perverse.

Kërkoni gjithmonë leje për të filmuar ose fotografuar individët, megjithëse kjo mund të mos jetë e nevojshme në

një mjedis publik. Në rast se është e mundur, lejen kërkojeni me shkrim.

Evitoni të përdorni pamjet seksi dhe fotot që pasqyrojnë një klichë – një vajzë me duar të lidhura në hekura, ose një person me një barkod mbi të, ose një fëmijë prapa hekurave apo në shtëpi publike. Këto lloj trajtimesh kontribuojnë në krijimin e stereotipave rreth trafikimit, që mund të jenë disorientuese. Për shembull, shumë viktime të trafikimit janë persona që kanë mbijetuar dhe janë duke e marrë veten. Shumë prej tyre mund të mos jenë shtyrë me dhunë drejt shfrytëzimit, por më vonë duke u manipuluar bëhen të varur edhe emocionalisht.

Evitoni pamje të forta të ushtrimit të dhunës. Është shumë e rrallë që pamjet e dhunës ekstreme të jenë të nevojshme dhe në interes të publikut. Në përgjithësi, redaktorët dhe prodhuesit e dokumentarëve duhet të konsiderojnë sesa do të jenë të pranueshme pamjet e dhunës trupore? Ku do të duhet të vihet viza ndarëse? A është e justifikueshme shfaqja e shenjave, plagëve, të gjymtyrve të thyer të viktimave të skllavërisë dhe të trafikimit, për të përshkruar një ngjarje?

Nje gazetari e mirë do të rritë ndërgjegjësimin mbi anti-trafikimin nëpërmjet pamjeve dhe mesazheve që përforcojnë, dhe nuk thjeshtëzojnë apo shfrytëzojnë më tej viktimat dhe të mbijetuarit e trafikimit.

Ilustrimi i rastit: paratë....



Nga trafikimi njerëzor fitohen \$9 deri në \$31.6 miliardë në nivel global

Ose seks.....



si do të ndihmojë një foto e një personi nga prapa, me një barkod mbi të që të humanizohet situata e të mbijetuarve të trafikimit njerëzor?

Seksi është ai që eksiton median

Puna e detyruar, trafikimi dhe skllavëria moderne janë çështje thelbësore, por janë ato të seksit që mbizotërojnë shpesh tek kryeartikujt e medias. Një analizë e hollësishme e rreth 3000 raporteve në median britanike gjetën që tregimet mbi trafikimin njerëzor për shfrytëzim seksual ishin ato që mbuloreshin nga media më shumë se sa ato të lidhura me punën e detyruar apo skllavërinë moderne sipas raportit të Joseph Rowntree Foundation në 2013. Ky raportim mund të jetë një portë për një diskutim më të gjërë të problemit, por sipas kërkimeve të bëra, ka një fakt dramatik të mos raportimit në shkallën e duhur të një problemi shumë më të shtrirë, të atij të skllavërisë moderne.

Migrimi: si e shtrëmbëron politika mbulimin mediatik

Zërat negativë mbi imigrimin duket sikur tërheqin vëmendjen e medias më shumë se sa raportimi mbi trafikimin, madje edhe kur ai ndodh në pragun e derës suaj. Raportet e vendeve, të hartuara nga Rrjeti i Gazetarisë Etike dhe Qendra Ndërkombëtare e Zhvillimit të Politikës së Migrimit (ICMPD) në 2015⁹ dhe në 2016¹⁰ përmbajnë prova të qarta që ndikimi i panevojshëm politik mbi median, i bazuar shpesh mbi informacione fallso ose të shtrëmbëruara, largon fokusin nga problemet më të thella, si ato të punës së detyruar, punës së fëmijëve dhe trafikimit. Sfida për median dhe gazetarinë është që t'i përkushtojnë hapësirën e duhur problemeve të vërteta e reale të imigrimit, dhe në të njëjtën kohë, të ekspozojnë dhe raportojnë abuzimet e së drejtës së njeriut që ndodh mu në mes të ditës.

⁹ Shih <http://ethicaljournalismnetwork.org/resources/publications/moving-stories>

¹⁰ Shih <http://ethicaljournalismnetwork.org/resources/publications/media-mediterranean-migration>

05.

Lidhjet dhe kontaktet:

SHKURTESAT

ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës
ICAT	Grupi i Koordinimit Shumë-agjenci Kundër Trafikimit
MMD	Dialogu mbi Migrimin dhe Mobilitetin (Afrika)
OSCE	Organizata për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Europë
ICMPD	Qendra Ndërkombëtare për Zhvillimin e Politikës së Migrimit
UNHCR	Komisioneri i Lartë i KoOmbëve të Bashkuara për Refugjatët
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migrimin
OHCHR	Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut
IDMC	Qendra e Monitorimit Ndërkombëtar të Zhvendosjeve
ICRMW	Konventa mbi Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve Migrantë
GMG	Grupi i Migrimit Global
GCIM	Komisioni Global mbi Migrimin Ndërkombëtar
CERD	Komisioni i OKB mbi Eliminimin e Diskriminimit Racor
PICUM	Platforma e Bashkëpunimit Ndërkombëtar mbi Migrantët e Padokumentuar

Disa nga nismat dhe burimet e rëndësishme të agjencive ndërkombëtare, rreth të cilave duhet të jenë të ndërgjegjshëm gazetarët dhe media:

Procesi i Rabatit	Dialogu Euro Afrikan mbi Migrimin dhe Zhvillimin
Procesi i Hartumit	Nisma e Bashkimit European mbi Rugëtimin e Migrimin të Bririt të Afrikës
	Dialogu i Afrikës Kontinentale brenda <u>Dialogut të Migrimin dhe Zhvillimit (MMD)</u>
Procesi i Budapestit	një proces këshillimor midis 50 vendeve për një migrim të rregullt
Procesi i Pragës	dialog me synim migrimin midis vendeve të Bashkimit European, të zonës Shengen, të Partneritetit Lindor, Ballkanit Perëndimor, Azisë Qendrore, Rusisë dhe Turqisë
Dialogu i Migrimin Tranzit Mesdhetar	një dialog këshillimor midis zyrtarëve që merren me migrimin dhe çështjet e ndërlidhura me të
Kompakti Global për Migrimin	një nismë e Kombeve të Bashkuara për një qasje gjithëpërfshirëse te migrimin
Plani global i veprimit për luftimin e trafikimit të personave	Strategjia e Kombeve të Bashkuara për trajtimin e trafikimit njerëzor
Organizata Ndërkombëtare e Punës	Organizata kyç e OKB për punën e detyruar dhe punën e fëmijës
Grupi i Koordinimit Ndër-agjenci kundër Trafikimit të Personave	Agjencitë e OKB që punojnë së bashku për të luftuar trafikimin
Aleanca kundër Trafikimit të Personave	Forum i gjërë ndërkombëtar i ngritur nga Organizata për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Europë
Aleanca 8.7	Aleanca ndërkombëtare për luftimin e punës së fëmijëve

Katedra e lajmeve mbi migrimin	E themeluar për gazetarët nga ana e Organizatës Ndërkombëtare për Migrimin
Historitë e migrimit	raportime nga Komisioner i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët
Projektet anti-trafikim	Përmbledhje veprimesh nga ana e Qendrës Ndërkombëtare të Zhvillimit të Politikës së Migrimit, e cila realizon kërkime shkencore të plota edhe në këtë lëmë, veçanërisht mbi trafikimin e qenieve njerëzore.

Rrjeti mediatik:

<https://www.freetheslaves.net/about-slavery/faqs-glossary/>

Një nga OJQ-të ndërkombëtare që bën punë të shkëlqyer këshillimore me gazetarët.

<https://gijn.org/human-trafficking-resources-best-practices-in-reporting/>

Burim i shkëlqyer me shembuj praktikash të mira dhe këshillash për gazetarët dhe organizatat e medias nga Rrjeti Global i Gazetarëve Hetimorë.

Më shumë shembuj të mbulimit mediatik:

<http://programm.ard.de/TV/Themenschwerpunkte/Politik/Aktuelle-Reportagen/Startseite/?sendung=28487337027833>

Një dokumentar i ARD mbi skllavërinë moderne në Gjermani, që trajton punën e detyruar, robërinë shtëpiake dhe shfrytëzimin seksual. Reporterët flasin me të mbijetuarit, punonjësit socialë, OJQ-të dhe policinë, në kërkim të mënyrave të ndalimit të skllavërisë moderne në Gjermani.

<http://www.zeit.de/wirtschaft/2016-05/sklaverei-ausbeutung-global-slavery-index-komplexitaet/komplettansicht>

Një artikull i hollësishëm rreth skllavërisë moderne i 31 maj 2016, i cili trajton mënyrën sesi kriza e refugjatëve krijon sfida të reja dhe fokusohet mbi mënyrën punën e detyruar që është bërë pjesë e strategjisë së biznesit global për të ulur kostot e mallrave të konsumit.

<http://youtu.be/APN4Q62uatk>

një dokumentar i fuqishëm rreth skllavërisë moderne në Francë nga një regjisor i pavarur, i porositur nga France Television, i transmetuar nga France 5 në 2016.

<https://www.theguardian.com/membership/audio/2016/may/23/patrick-kingsley-on-europes-refugee-crisis-guardian-live-event>

Patrick Kingsley, i Guardian dhe një nga gazetarët më në zë i Britanisë, bën reflektim mbi sfidat e raportimit të krizës së refugjatëve.

<https://www.theguardian.com/world/2015/apr/24/libyas-people-smugglers-how-will-they-catch-us-theyll-soon-move-on>

Një hetim i Guardian zbulon sesi ekonomia e peshkimit të Libisë është e stërbushur me kontrabandistë personash, të cilët kanë zaptuar peshkarexhat për të transportuar migrantë dhe refugjatë përmes Mesdheut.

Një përzgjedhje e udhëzimeve ekzistuese:

http://www.who.int/mip/2003/other_documents/en/Ethical_Safety-GWH.pdf

Rekomandimet mbi etikën dhe sigurinë të Organizatës Botërore të Ushqimit (WHO) për intervistimin e grave të trafikuar, 2003. Përveç materialit mbështetës, si justifikim për këto rekomandime, dokumenti i WHO përmban "Dhjetë parime orientuese për një realizim etik dhe të sigurt të intervistave me gratë që janë trafikuar".

https://www.unicef.org/media/media_tools_guidelines.html

Parimet dhe Udhëzimet e UNICEF mbi Raportimin Etik mbi Fëmijët. Qëllimi i këtij dokumenti është që "të ndihmojë median të mbulojë problemet e fëmijëve në një mënyrë të përshtatshme për moshën e tyre dhe me ndjeshmëri. Udhëzimet synojnë të mbështetin qëllimet më të mira të reporterëve etikë: të shërbyerit e interesit publik pa kompromentuar të drejtat e fëmijëve".

<https://www.unodc.org/documents/human-trafficking/2008/BP012TheRoleofthe-Media.pdf>

Nisma Globale e Kombeve të Bashkuara për të Luftuar Trafikimin (UN.GIFT) realizoi një studim me objektivin që të edukojë gazetarët dhe përmirësojë cilësinë e raportimit – Roli i medias në ndërtimin e imazheve (2008)

<http://www.astra.org.rs/en/pdf/novinari08ENG.pdf>

Një Manual mbi Trafikimin Njerëzor për Gazetarët (2008). Një manual i hartuar nga OJQ-ja serbe (Astra), për të ndihmuar median sesi të trajtojë trafikimin njerëzor;

gjithashtu i dobishëm për vendet e tjera kur këta vende hasen me sfida të ngjashme.

http://mirpal.org/files/files/Torgovlya_lyudmi.pdf

Në 2013, Unioni i gazetarëve Rusë (OJQ) dhe Fakulteti i Gazetarisë, Universiteti Shtetëror i Moskës, mbështetur nga OSBE, botoi një manual në gjuhën ruse për studentët dhe të diplomuarit e fakulteteve të medias “СМИ против ТЛ”, 2013.

<http://www.ethicaljournalismnetwork.org>

Botoi Udhëzimet mbi Raportimin e Migrimit dhe dy raporte ndërkombëtare në 2016 dhe 2017 mbi si duhet të raportojë media rreth çështjeve të migrimit, duke trajtuar problemet që hasen në 30 vendet e të gjithë rajonit të Mesdheut.



Oendra Ndërkombëtare e Zhvillimit të Politikës së Migrimit (ICMPD)
2017